



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**  
**K A V A J E**

**RAPORT- ANALIZE**

**MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT**  
**DHE VEPRIMTARISE SE PROKURORISE PRANE**  
**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**  
**KAVAJE PER VITIN 2016**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**  
**K A V A J E**

Adresa : Lagja nr.5 Rr “Unaza Qytetit”

Kavaje me 22.02.2017

**R A P O R T - A N A L I Z E**

**Veprimtaria dhe treguesit kryesore te punes per vitin 2016. nga Prokuroria  
prane Gjykates se Shkalles se Pare Kavaje.**

Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Kavaje analizon ne kete raport veprimtarine e punes te periudhes 1-vjeçare per vitin 2016, gjendjen e kriminalitetit ne juridiksionin qe ushtron veprimtarine e saj, permbushjen e detyrimeve ligjore, me arritjet, mangesite dhe problematikat e evidentuara gjate veprimtarise se saj, si dhe percaktimin e prioriteteve dhe drejttimeve kryesore per persosjen e metejshme te veprimtarise se saj ne te ardhmen ne funksion te zbatimit te ligjit.

Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Kavaje e ka ushtruar veprimtarine e saj ne mbeshtetje dhe respektim te plote te dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato qe burojne nga marreveshjet nderkombetare shume paleshe dhe dypaleshe, te ratifikuara me ligj nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise, duke respektuar dhe urdherat dhe udhezimet te Prokurorit te Pergjithshem te Republikes se Shqiperise.

Prokuroret dhe Of/Pol/Gjyqesore te Prokurorise, duke perfshike ketu dhe trupen e sherbimeve te Policise Gjyqesore prane Komisarjatis te Policise Kavaje, gjate kesaj periudhe qe analizojme rezulton se i jane perkushtuar punes, duke ju permbajtur respektimit te ligjit si detyrim paresor, krijuar kushtet ligjore te zbatimit te drejtave te njeriut, per arritjen dhe venien para pergjegjesise penale te autoreve te kryerjes se veprave penale, por dhe duke zbatuar dhe respektuar te drejtat procedurale ndaj tyre gjate procesit hetimor.

Gjate vitin 2016, per perballimin e punes dhe ushtrimin e veprimtarise Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje ka patur ne perberje te organikes se saj 6-Prokurore, perfshire Drejtuesin, 3-oficere te policise gjyqesore, si dhe 6-punonjes te administrates.

Treguesit e punes tone ne pergjithesi dhe asaj ne veçanti te çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqesore, do ta realizonim duke ju referuar te dhenave statistikore 1-vjeçare qe analizojme pra vitit 2016.

**I. Volumi i kallzimeve penale-akteve te referuara, dhe çeshtjeve penale te trajtuara gjate vitit 2016.**

Jane regjistruar (*protokolluar*) ne sekretarine e Prokurorise Kavaje, referuar per vepra penale per vitin 2016, **1078 -materiale** (113-me shume se 2015) nga keto 986-te referuara nga sektoret e sherbimeve te Pol.Gjyqesore prane Komisarjatit te Policise Kavaje, 60-materiale kallzuese nga Institucionet, 32-materiale kallzuese nga qytetaret.

Pra evidentohet nje tendence rritje nga viti i meparshem 2015, e referimeve per fakte dhe ngjarje kriminale, gje qe do te analizohet nga treguesit konkrete per grup veprash penale.

**Evidence e Refererimeve dhe kallzimeve te regjistruara ne Prokurori**

Viti	Referime nga sherbimet e policise	Kallzime nga Institucionet	Kallzime nga shtetasit	Gjithsej
2014	1094	25	19	<b>1169</b>
2015	937	18	10	<b>965</b>
2016	986	60	32	<b>1078</b>

Te gjitha rastet e akteve te referuara apo kallzimeve te paraqitura jane trajtuar me pergjegjesi, duke i evidentuar ne regjistrat perkates, duke marre vendime perkates ligjore, regjistrimi apo mosfillimi te çeshtjes penale.

Nga kallezimet penale dhe referimet per **423-raste eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal** ne baze te nenit 290-291 te K.Pr.Penale (*nr.me i konsiderueshem ne vite*) ku ne vitin 2013 ka patur 157 - mosfillime, ndersa ne 2014 ka patur 392-mosfillime, ne vitin 2015 ka patur 413- mosfillime, ndersa **eshte vendosur regjistrimi per 620- çeshtje penale** (*nga 497 per vitin 2015 pra 123 -çeshtje te rregjistruara me shume se nje vit me pare*).

Me qarte veprimtaria e Prokurorise do te rezultoj duke analizuar treguesit sipas dinamikes se trajtimit dhe vendimarrjes referuar dhe praktikes procedurale qe ndiqet, nga momenti i konstatimit te veprave penale nepermjet vend-ngjarjeve, kallzimeve penale etj, trajtimit ne aspektin ligjor, shpejtesise ne hetim etj, qe te krijojm nje tablo sa me te qarte te pasqyrimet te rezultateve apo mangesive dhe problematikave te evidentuara.

## II. MOSFILLIMET (sipas neneve 290-291 te K.Pr.Penale)

Eshte vendosur mosfillimi i proçedimit penal ne baze te neneve 290/ dhe 291/ te K.Pr.Penale per **423-referime aktesh**.

Sa i perket tendences te natyres se veprave penale te referuara, ne numrin 423-te vendimeve te mosfillimit rezultojne ne numer te konsiderueshem si me poshte:

- per nenin 89-90 te K.Penal jane 41-vendime mosfillimi,
- per nenin 84 te K.Penal jane 45 vendime mosfillimi,
- per nenin 99 te K.Penal jane 41-vendime mosfillimi,
- per nenin 130/a/ te K.Penal jane 32-vendime mosfillimi,
- per nenin 277 te K.Penal jane 19-vendime mosfillimi, dhe
- per nenin 199/a/1 te K.Penal jane 33-vendime mosfillimi.

Ne te gjitha rastet, ne arsyetimin e vendimeve eshte bere dhe orientimi per t'ju drejtuar Gjykates per raste konkrete me padi civile apo ankim direkt ne Gjykate sipas nenit 59 te K.Pr.Penale.

Ndersa ne lidhje me vepren penale te parashikuar

- nga neni 290/1 te K.Penal (Shkelja rregullave te qarkullimit rrugor) eshte vendosur mosfillimi per 31-raste.

Ky numer duhet konsideruar i ndjeshem per kete veper penale ne ngarkesen e punes se Prokuroreve, duke patur parasysh se jane raste te veprimeve hetimore me vend-ngjarje, qe permbajne ne teresine e tyre te gjithe dinamiken e veprimeve per nje çeshtje konkrete, pra nje volum, por qe per shkak te elementit te pasojes ne keto raste eshte vendosur sipas nenit 290/ dhe 291/ te K.Pr.Penale.

Duhet evidentuar fakti qe ne te gjitha rastet e siperpermendura per nenin 290/1 te K.Penal nuk ka patur ankime ne Gjykate, çka konfirmon zgjidhjen e drejte te ketyre rasteve. Gjithashtu per te gjitha rastet duhet evidentuar njoftimi dhe Sektorit te Policise Rrugore per marrjen e masave administrative (vendosjen e gjobave) ndaj drejtuesve te automjeteve.

Per 41-raste te (*tentatives per vetevrasje neni 99 K.P*), jane marre deklarime te sakta personave qe kane dijeni per faktin, dhe pas evidentimit te mungeses se elementeve te ndonje vepre penale (kryesisht per nenin 99 te K.P) eshte vendosur mosfillimi.

Ne te gjitha rastet e mosfillimit te çeshtjeve jane bere njoftimet e vendimeve te mosfillimit paleve te interesuara gje qe evidentohet si nga korespondenca e shkreses ashtu dhe kopjet e vendimeve te konfirmuara dhe te administruara ne fashikujt perkates.

Nga 413 - vendime mosfillimi, *jane **ankimuar 5-vendime*** prane Gjykates se rrethit Gjyqesor Kavaje, per te cilat per 2 - raste eshte vendosur prishja e

vendimit te mosfillimit, ku pas ankimit te Prokuroreve per 2-vendime eshte lene ne fuqi vendimi i Shkalles se Pare nga Apeli dhe çeshtjet jane rifilluar. Ndersa per 2 – raste eshte lene ne fuqi vendimi mosfillimit te Prokuroreve. Ndersa per 1-rast eshte ne gjykim.

Duhet evidentuar fakti se nje pjese e madhe e kallzimeve per te cilat eshte vendosur mosfillimi, jane kryer verifikime faktesh rrethanash apo administrim dokumentash, duke argumentuar plotesisht shkaqet e mosfillimit.

### **Evidence e trajtimit te rasteve ne faze verifikimi (Mosfillimet)**

Regjistruar ne faze verifikimi	Mosfilluar	Mbartur ne 2017	Ankuar	Dinamika e zgjidhjes
450	423	27	5	2-prishur (rifilluar) 2-lene ne fuqi 1- ne gjykim

- Pra referuar evidences se mesiperme rezulton se eshte bere nje pune e mire ne lidhje me trajtimin e materieleve fillestare, ku ankimet vetem per 5-vendime mosfillimi eshte nje tregues domethenes per cilesine e vendimarrjes se mosfillimeve.
- Duhet evidentuar fakti se pergjithesisht eshte respektuar afati 30-ditor ne nje pjese te konsiderueshme te rasteve te mosfilluara.
- Por ka patur raste se ndonese data ne vendim mund te jete vendosur brenda afatit qe parashikon Urdheri i Prokurorit te Prgjithshem, ne zyren e Drejtuesit, fashikulli per kontroll eshte paraqitur me kohe vonese, kjo e pasqyruar ne shkresat perkatese.
- Rezulton se ne referimet qe kalojne per vleresim dhe verifikim, ne momente te caktuara nuk ka patur nje dinamike ne vazhdim.
- Duhet evidentuar se, si shkak kryesor ne kalimin e ketij afati, rezultojne referimet e akteve me mangesi (te dukshme), apo raste te konflikteve te pronesis se qe kane te bejne me administrim te praktikave administrative apo gjyqesore per te bere nje konkludim te sakte ne vendim, si dhe vonesat ne konfirmimet e akteve te ekspertimit mjeko-ligjor.

### III. CESHTJE PENALE TE REGJISTRUARA DHE HETUARA.

Ne vitin 2016 jane regjistruar gjithsej 620-çeshtje penale.

Ketij numri duhet shtuar dhe 172-çeshtje penale te mbartura nga viti 2015, ku rezulton se numri i pergjithshem i çeshtjeve te hetuara per periudhen qe analizojme per vitin 2016 eshte **792-çeshtje penale te hetuara.**

*Duhet evidentuar fakti se gjate dinamikes se hetimeve, per 12- proçedime eshte vendosur bashkimi, dhe per 5-proçedime eshte vendosur ndarja e proçedimit, ndersa eshte vendosur ri-fillimi i hetimeve ne 7-çeshtje penale.*

Kane perfunduar hetimet gjithsej per **647-çeshtje penale.**

Pra nga numri i pergjithshem i kallzimeve penale dhe i çeshtjeve te regjistruara rezulton se gjate kesaj periudhe ka patur nje rritje te kallzimeve dhe çeshtjeve penale te regjistruara dhe hetuara, dhe konkretisht ne vitin 2012 jane regjistruar 294-proçedime penale, ne vitin 2013 jane regjistruar 600, ne vitin 2014 jane regjistruar 684-çeshtje penale, ne vitin 2015 jane regjistruar 497-çeshtje penale ndersa ne vitin 2016 jane regjistruar 620-çeshtje. (123-çeshtje me shume se viti 2016)

#### **Evidence e çeshtjeve te regjistruara dhe hetuara**

Viti	Mbartur nga viti para - ardhës	Regjistruar	Gjithsej Hetuar	Perfunduar
2014	195	684	879	480
2015	199	496	695	523
2016	172	620	792	647

#### **DREJTIMET, SHTRIRJA DHE TENDENCAT E PERHAPJES SE VEPRAVE PENALE NE PERGJITHESI DHE /OSE GRUP VEPRAVE PENALE NE VEÇANTI.**

Sa i perket tendences se natyres kriminalitetit, te perhapjes se veprave penale ne pergjithesi apo me grup veprash penale te veçanta rezulton se veprat penale me nje shtrirje dhe perhapje me te madhe jane ato **kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike me 451-proçedime penale.** (bashke me te mbartura)

Evidentojme se per nenin 134/ te K.Penal 376-proçedime penale, nenin 199/a/- te K.Penal 42-proçedime penale, per nenin 137/ te K.Penal 11-proçedime penale, per nenin 197 te K.Penal 14-proçedime penale.

Pas ketij evidentimi duhet permendur veprat penale qe kane te bejne me krime **kunder autoritetit te shtetit, respektivisht 201-proçedime penale** ku per neni 248 K.Penal 15-proçedime penale, neni 283/1,2 K.Penal 27-proçedime penale, neni 290/ K.Penal 38-proçedime penale, neni 291 K.Penal 36-proçedime penale etj (bashke me te mbartura)

Veprat penale te drejtuara **kunder jetes se personit rezultojne se jane regjistruar 99-proçedime penale**. Nga keto 2-proçedime penale per nenin 76-78 K.Penal (1-konsumuar me nje viktime) 2-proçedime per nenin 78 te K.P, per nenin 79/dh 3-proçedime, per nenin 88 te K.Penal 4-çeshtje penale, per nenin 84 te K.Penal 9- çeshtje penale, per nenin 89 te K.Penal 18-çeshtje penale, ndersa per nenin 130/a/.. te K.Penal rezultojne 51-çeshtje penale.

Duhet evidentuar dhe numri i ndjeshem per vepren penale te “Drejtimi i automjetit ne menyre te parregullt” neni 291 te K.Penal, ku rezultojne 36-çeshtje te regjistruara.

Duhet evidentuar dhe numri i ndjeshem per vepren penale te “Ndertimi i paligjeshem” neni 199/a/1,2 te K.Penal, ku rezultojne 44 - çeshtje te regjistruara.

Duhet evidentuar dhe numri i ndjeshem per vepren penale te “Dhuna ne familje” neni 130/a/1-4 te K.Penal, ku rezultojne 51 çeshtje te regjistruara.

Duhet evidentuar dhe numri i vogel i referimeve per vepren penale te “Vjedhja e energjise elektrike” neni 137/ te K.Penal, ku rezultojne vetem 21 - çeshtje te regjistruara.

### III. MENYRA E PERFUNDIMIT TE ÇESHTJEVE.

( Personat ne hetim, masa sigurimit, pushimet, pezullimet dhe te derguara per gjykim)

Kane perfunduar hetimet dhe eshte konkluduar ne vendim perfundimtar per 647 çeshtje penale per vitin 2016, duke mbartur ne hetim 145-çeshtje penale per vitin 2017. (ulje e çeshtjeve te mbartura , pra 27 me pak kete vit)

Rezulton se nga **647 - çeshtje te perfunduara:**

- **232 - çeshtje jane derguar per gjykim,** (pra 29.3 % e tyre),
- **112 -çeshtje jane pushuar** (14.1 %)
- **293- çeshtje jane pezulluar** (37 %),
- **10 -çeshtje jane transferuar per kompetence**
- **145- çeshtje jane mbartur per vitin 2017.**

Mbartur	Regjistruar	Gjithsej Hetuar	Gjygit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mbartur ne hetim 2017
172	620	792	232	112	293	10	145

#### • **PERSONA NEN HETIM**

Ne keto procedime penale rezulton se eshte regjistruar emri i 361-personave me cilesine e te dyshuarit per nje veper penale ne vendimin e regjistrimit, pra me cilesine ndaj te cileve zhvillohen hetime. (102-persona nen hetim me shume se viti 2015)

Nga keta kane perfunduar hetimet per 296-persona, ku 268-personave u jane njoftuar akuzat perkatese „njoftimit te akuzes neni 34 K.Pr.P“ dhe jane derguar per gjykim, per 9-persona nen hetim eshte vendosur transferimi i procedimeve penale, ndersa per 19-persona te regjistruar emri eshte vendosur pushimi i çeshtjes penale (17-persona me pak se viti 2015) ne ngarkim te tyre, ndersa rezultojne 65- persona nen hetim te mbartur per vitin 2017.



• **MASAT E SIGURIMIT**

Nga personat nen hetim mbi bazen e referimit te akteve paraprake kane ardhur me mase shtrenguese te vendosur nga sherbimet dhe seksioni i Pol/Gjyqesore, “arrest ne flagrance“ 164-te dyshuar dhe “ndalim“ 15- te dyshuar pra gjithsej **179-persona te dyshuar me mase shtrenguese per vitin 2016.** (pra 80-masa shtrenguese me shume se viti 2015)

Eshte kerkuar **vleftesimi** i arrestit ne flagrance dhe ndalimit per 179 - persona te dyshuar.

Gjykata per 179 - raste ka vleftesuar te ligjeshem masat shtrenguese.

Nga Prokuroria eshte kerkuar **caktim mase sigurimi** ndaj 179-personave te dyshuar, ku eshte kerkuar masa e sigurise per

- **108-te dyshuar „arrest ne burg“** sipas nenit 238 te K.Pr.Penale,
- **10-te dyshuar “arrest ne shtepi”** sipas nenit 237 te K.Pr.Penale,
- **3-te dyshuar “arrest ne burg” me afat,**
- **3-te dyshuar “garanci pasurore“** sipas nenit 236 te K.Pr.Penale,
- **75-te dyshuar “detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore“** sipas nenit 234 te K.Pr.Penale.
  
- Per **5-persona te dyshuar** gjate hetimeve paraprake eshte kerkuar **masa e sigurimit “arrest ne burg” ne mungese dhe miratuar nga Gjykata.**

Nga **Gjykata eshte vendosur** per

- 105-persona “arrest ne burg”,
- 10-persona “arrest ne shtepi”,
- 3-persona “arrest ne burg me afat”,
- 1-persona “garanci pasurore”
- 78-persona masa e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore”.

**Te dhenat permbledhese per autoret dhe masat e sigurimit**

Regjistruar emri nen hetim	Te pandehur (njotuar akuza)	Masa sigurimit				Gjykim	Pushuar	Transferuar	Ne hetim
		Neni 234	Neni 236	Neni 237	Neni 238				
361	268	78	1	10	105	268	19	9	65

*Me poshte po analizojmë menyren e perfundimit te ceshtjeve te regjistruara dhe hetuara, dhe konkretisht.*

**a) CESHTJE TE DERGUAR NE GJYKATE**

Pas perfundimit te hetimeve jane derguar per gjykim prane Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Kavaje **232-procedime penale me 268 - te pandehur.**

Nga te cilet me mase sigurimi "Arrest ne Burg" jane derguar per gjykim 105-te pandehur (bashke me te mbarturat nga 2015).

Duke ju referuar veprave penale per te cilen jane akuzuar e derguar per gjykim te pandehurit, rezulton si me poshte :

- Per vepren penale **kunder autoritetit te shtetit** (kunder veprimtarise shteterore-kunder rendit dhe sigurisene net 235-299 te K.P) jane derguar per gjykim 86 - procedime penale me 100 - te pandehur ku nga keto 26 te arrestuar.
  - *Duhet evidentuar se rezultojne per nenin 236 te K.Penal 2-procedime penale me 2-te pandehur nga keto 1-te arrestuar.*
  - *Per vepren penale te "Mosbindja ndaj punonjesit te policise se rendit" neni 242 i K.Penal 11-procedime penale me 12-te pandehur.*
  - *Per vepren penale te "Shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor" neni 290/ i K.Penal 7-procedime penale me 7-te pandehur.*
  - *Per vepren penale te parashikuar nga neni 291 te K.Penal jane derguar per gjykim 18- procedime penale me 18-te pandehur me 3-te arrestuar.*
  - *Per vepren penale te parashikuar nga neni 248 te K.Penal jane derguar per gjykim 4- procedime penale me 9-te pandehur me 7-te arrestuar.*
- Per veprat penale **kunder pasurise** 134/-200 te K.Penal jane derguar per gjykim 82-procedime penale, me 102-te pandehur ku nga keto 28-te pandehur te arrestuar.

*Evidentojme se per:*

- *nenet 134/1,2 te K.Penal 25-procedime me 33-te pandehur ku nga keto 24-te arrestuar,*
- *neni 137/1,2 i K.Penal 14-procedime me 17-te pandehur,*
- *neni 199/1,2 te K.Penal 29-ceshtje me 31-te pandehur.*

- Per veprat penale **kunder jetes se personit** nenet 76-133 te K.Penal jane derguar per gjykim 15-procedime penale, me 15-te pandehur ku nga keto 12-te arrestuar.

*Evidentojme se per*

- *nenit 88 te K.Penal jane derguar per gjykim 3-procedime penale me 3-te pandehur ku 1- me mase sigurime "arrest ne burg,*
- *per nenin 89 jane derguar per gjykim 6-ceshtje me 6-te pandehur,*
- *per nenin 130/a/1,4 jane derguar per gjykim 33-ceshtje me 33-te pandehur me 16- me mase sigurimi arrest ne burg.*

*Duhet evidentuar, se çeshtjet penale te derguara per gjykim per vepren penale te "vrasjes", te gjitha rastet jane vleresuar hetimet maksimalisht, jane siguruar prova te plota dhe te pakontestueshme, jane kryer veprime hetimore te shoqeruara me akte ekspertimi, pergjime ambientale e telefonike etj, duke arritur dhe kapjen e autoreve dhe me pas vendosjen e mases se sigurimit "arrest ne burg" e derguar per gjykim.*

- Per veprat penale **kunder drejtesise** nenet 300-324/a te K.Penal jane deguar per gjykim 15-procedime penale, me 15-te pandehur ku nga keto 12-te arrestuar.

*Evidentojme se per nenin 324/a/1 te K.Penal jane derguar per gjykim 10-procedime penale me 10-te pandehur ku 10- jane me mase sigurime "arrest ne burg, per nenin 320 te K.Penal jane derguar per gjykim 3 - çeshtje penale me 3 - te pandehur,*

### **CESHTJE PENALE TE PERFUNDUARA GJYKIMI PER VITIN 2016**

Gjate vitit 2016 pas dergimit te çeshtjeve penale per gjykim, ka perfunduar gjykimi per 229-procedime penale me 265-te pandehur nga te cilet 78-te pandehur me mase sigurie "arrest ne burg". (perfshire dhe dosjet ne gjykim te mbartura nga 2015)

#### **Nga Prokuroria**

- Per 104 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim.

Nga te cilet vetem per 23 - te pandehur ne kufijte prane minimumit te denimit, 81-te pandehur ne kufijte mesatar te denimit.

- Per 114-te pandehur eshte kerkuar pezullimi i ekzekutimit te denimim me burgim ( neni 59 K.Penal) duke perfshire ketu dhe nenin 63 te K.Penal.
- Eshte kerkuar denimi me gjobe per 44-te pandehur.
- Per 5-çeshtje (me 5-te pandehur) eshte kerkuar pushimi i gjykimit te çeshtjes, per efekt te heqjes dore nga ankimi ne Gjykate (çeshtje me ankim neni 89 K.P).
- Nga **Gjykata** ne lidhje me kerkesat e bera nga Prokuroria qe parashtroam me siper eshte vendosur deklarimi fajtor per 257 te pandehur (nga 260 te kerkuar nga Prokuroria pasi per 3-te pandehur eshte vendosur pafajesi).
- Eshte vendosur denimi me burgim per 101-te pandehur (nga 104-te kerkuar nga Prokuroria)
- Eshte vendosur denimi sipas nenit 59 dhe 63 te K.Penal per 113-te pandehur.

Evidentojmë faktin që një pjesë e madhe e denimeve me kusht (pezulluara ekzekutimin e denimit me burg nën 59 K.P) dhe detyrimin për të bërë një punë me interes publik kanë të bëjnë me vepra penale të parashikuara nga nenet 291 dhe 199/a/1 të K.penal.

- Është vendosur denimi me gjobe për 41 të pandehur (nga 44-të kërkuar nga Prokuroria)

Siç shikohet nga statistika e mesipërme raporti i kërkesave për masë denimi të Prokurorisë me vendimet e dhëna nga Gjykata rezultojnë një raport pa ndryshime thelbësore si në llojin ashtu dhe në masën e denimit. Në këtë vështrim janë analizuar dhe qendrimet për apelim me këtë raport ndryshimesh të kërkesave dhe dhenies së vendimeve.

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë është vetëm 1-çeshtje të dhenies së pafajësisë, me një të pandehur. Ndërsa për 2-çeshtje të tjera të mbartura nga viti 2013, janë dhënë për dy të pandehur pafajësi ndërsa për të pandehurit e tjere fajësi.

### **Ankimet në Gjykatën e Apelit**

Nga Çeshtjet e gjykuara dhe të perfunduara në Gjykatën e Rrethit të Gjyqësor Kavajë në 11- raste është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Është ushtruar ankim për 2-vendime për masë sigurimi ku në përfundim të gjyqimeve në Apel nuk është pranuar kërkesa e Prokurorisë që ka të bëjë me masën e sigurimit “arrest në burg”.

Gjithashtu është ushtruar ankim për 9-çeshtje, vendimi themeli të cilat në 4 - raste është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës Kavajë, dhe në rastet e tjera nuk ka përfunduar gjykimi në Apel.

Çeshtje të Gjykuara	Të pandehur	Fajësi	Pafajësi	Ankim	Gjykata Apelit
Kërkesa Prokurorisë	232	227		9	
Vendimi Gjykatës	232	224	3		4-mos pranuar ankimi 5-jane në gjykim

### **b) PROCEDIMET PENALE TE PUSHUARA**

Gjate ketij viti nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kavaje eshte vendosur pushimi per 112-procedime penale me 19-autore te regjistruar emri.

Duke ju referuar statistikes rezulton se :

Per 3-procedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/a te K.Pr.Penale.

Per 12-procedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/dh te.K.Pr.Penale per mungese provash.

Per 97- procedime penale jane pushuar per shkaqe te tjera.

Duke ju referuar grup veprave penale per te cilat eshte rregjistruar procedimi rezulton se eshte vendosur pushimi si me poshte :

Konkretisht

- per nenin 248 te K.Penal 7-procedime penale.
- per nenin 290/1,4 te K.Penal 17-procedime penale me 10-persona ne hetim,
- per nenin 291 te K.Penal 2- procedime penale me 2-persona ne hetim,
- per nenin 199/a/1 te K.Penal 9- procedime penale me 9-persona ne hetim,
- per nenin 130/a/1 te K.Penal 10 - procedime penale me 6-persona ne hetim,
- per nenin 89 te K.Penal 1 - procedime penale me 1-persona ne hetim,
- per nenin 283/1 te K.Penal 5- procedime penale,
- per nenin 84 te K.Penal 1- procedime penale.

Ne 6-raste eshte bere ankimim ne Gjykate ndaj vendimeve te pushimit.

Ne 2-raste eshte prishur vendimi duke e kaluar per ri-hetime.

Per 4-raste te tjera jane ne gjykim.

### **c) PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA**

Eshte vendosur pezullimi i hetimeve ne baze te nenit 326/1,2 te K.Pr.Penale per 293 procedime penale te cilat jane te ndara me grup veprash:

- Vepra penale kunder pasurise rezultojne 246-procedime penale.

Keto procedime penale kryesisht jane me vend-ngjarje te referuara nga seksionet e policise gjyqesore prane Komisarjatisht te Policise Kavaje.

Ne te gjitha rastet eshte urdheruar kryerja e veprimeve hetimore si dhe deleguar veprime te posaçme ne veprime te veçanta dhe ne perfundim bazuar dhe ne relacionin e oficerëve te policise gjyqesore eshte vendosur pezullimi i hetimeve.

Ne kuptimin e figurave te krimit te ketyre grup veprave penale duhet nenvizuar se per nenin 134/ te K.Penal rezulton pjesa me e madhe e tyre.

#### **d) PROCEDIMET PENALE TE TRANSFERUARA**

Eshte vendosur trasferimi per kompetence per 10-procedime penale nga te cilet 2 - jane transferuar per kompetence lendore Prokurorise Per Krime te Renda, ndersa te tjerat rast pas rasti per kompetence tokesore Prokurorive perkatese.

Ne asnje rast te shpalljes se moskompetences dhe kalimit te akteve nuk kemi patur konflikt per zgjidhjen e kompetences drejtuar Zyres se Prokurorit te Pergjithshem. Pra evidentojme faktin qe vendimet kane qene te arsyetuara dhe te bazuara ne dispozitat proceduriale per kompetencen.

#### **IV. SHPEJTESIA ME HETIMET PARAPRAKE DHE AFATET E PARABURGIMIT**

Nga treguesit kryesor te veprimtarise se punes se Prokuroreve dhe trupes se of/pol/Gjyqesore te Prokurorise dhe sherbimeve prane Komisariatit te Policise Kavaje, eshte shpejtesia e veprimeve hetimore ne hetimet paraprake e cila ka te beje ne respektimin e dispozitave proceduriale penale per afatet e hetimit dhe ne veçanti ato te paraburgimit me te pandehur te arrestuar . Rezulton se pergjithesisht jane respektuar kriteret e afateve te hetimit.

Rezulton se gjate hetimeve paraprake eshte kerkuar zgjatja afati hetimor per **40-procedime penale ( 5 %) nga 792-çeshtje te hetura gjithsej**. Konkretisht eshte kerkuar zgjatje e afatit te hetimit per:

- 1-3 muaj per 30-procedime penale,
- 3-6 muaj per 6-procedime penale,
- mbi 6-muaj per 4-procedime penale.

Ne lidhje me afatet e paraburgimit **nuk ka asnje rast te kalimit te ketyre afateve**, per rrjedhoje nuk kemi asnje kerkese drejtuar Gjykates per zgjatjen e afatit te paraburgimit.

Duhet evidentuar fakti se jo rralle zgjatjet jane vendosur per shkak te zvarritjes se veprimeve nga sherbimet e pol.gjyqesore te cilat kane relatuar me vonese per dinamiken dhe gjendjen e hetimeve.

Eshte detyre e Prokurorit qe here pas here te kerkoje dosjet, dhe ne rastet e konstatimit te mungeses se veprimtarise hetimore te relatoje tek Drejtuesi per kalimin ne proces disiplinor.

## V. EKZEKUTIMI I VENDIME PENALE

Ne vitin 2016 jane nxjerre nga Prokurori i ekzekutimeve te vendimeve penale 250 urdhra ekzekutimi vendimesh penale, te dhena nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Kavaje.

Nga keto 90-urdhera ekzekutimi te denimit me burgim, 39-urdhera denimi me gjobe, 121-denime alternative (kusht-99) dhe pune me interes publik sipas nenit 63 te K.P per 20 - urdhera ekzekutimi, si dhe 3 - urdhera per mjekim te detyrueshem sipas nenit 46 te K.Penal, dhe 2-urdhera per lirim para kohe me kusht sipas nenit 64 te K.Penal.

Ne te gjitha rastet eshte urdheruar dhe ekzekutimi i shpenzimeve procedurale.

Rezultojne 2-kerkesa per nxjerrjen e kerkimit nderkombetar, nga te cilat njera eshte ekzekutuar, si dhe 2-leter porosi (notifikime).

Mos ekzekutimi i urdherave per masa sigurimi dhe denime ne mungese, ka ardhur per shkak te mos gjetjes nga kerkimet e policise te autoreve te dyshuar apo denuar.

Ndersa ne lidhje me ekzekutimin e vendimeve me gjobe ne çdo rast jane evidentuar praktikat nga Zyra e Permbarimit ku eshte drejtuar urdheri i ekzekutimit.

*Keto ishin treguesit kryesore te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor ne lidhje me gjendjen e kriminalitetit, drejtimet dhe perhapjen e tij, numri i pergjithshem i regjistrimit te çeshtjeve, mosfillimeve, menyres se perfundimit, perfaqesimeve ne gjykim, treguesit e shpejtesise si dhe ne menyre te pergjithshme cilesia e tyre ne raportet e kerkesave me vendimet e gjykateve .*

%%%%%%%%%

## **VI. Veprimtaria dhe ngarkesa e Prokuroreve dhe Of/Pol/Gjyqysore.**

Por per te qartësuar veprimtarin, punen individuale per çdo Prokuror dhe Of/Pol/Gjyqesore po paraqesim dhe treguesit per secilin ne veçanti :

### **Prokurori Ornela Rrumbullaku**

Hetuar - 175 proçedime penale  
Mosfilluar - 72 kallzime

Derguar ne gjyq - 66 proçedime penale  
Pushuar - 30 proçedime penale  
Pezulluar - 59 proçedime penale  
Transferuar - 2 proçedime penale  
Mbartur ne hetim - 28 proçedime

Zgjatje afati - 1-çeshtje

Pjesemarrje ne gjykim me objekt sipas nenit 64-59/a te K.P - 13-gjykime

### **Prokurori Ylli Dhimitri** (ngarkuar dhe me ekzekutimet e vendimeve)

Hetuar - 174 proçedime penale  
Mosfilluar - 103 kallzime

Derguar ne gjyq - 56 proçedime penale  
Pushuar - 23 proçedime penale  
Pezulluar - 59 proçedime penale  
Transferuar- 2 proçedime penale  
Mbartur - 34 proçedime penale

Zgjatje afatesh- 8-çeshje

Pjesemarrje ne gjykim me objekt sipas nenit 64-59/a te K.P - 46-gjykime

### **Prokurori Durim Bedini**

Hetuar - 160 proçedime penale  
Mosfillime - 97 kallzime

Derguar ne gjyq - 46 proçedime penale  
Pushuar - 17 proçedime penale  
Pezulluar - 67 proçedime penale  
Transferuar - --- proçedime penale  
Mbartur - 30 proçedime penale

Zgjatje afatesh- 6-çeshje

Pjesemarrje ne gjykim me objekt sipas nenit 64-59/a te K.P - 17-gjykime



### **Prokurori Shyqyri Duro**

Hetuar - 35 proçedime penale  
Mosfilluar - 31 kallzime

Derguar ne gjyq - 8 proçedime penale  
Pushuar - 9 proçedime penale  
Pezulluar - 54 proçedime penale  
Transferuar - 1 proçedime penale  
Mbartur- 13 proçedime penale

Zgjatje afatesh- 4 çeshje

Pjesemarrje ne gjykim me objekt sipas nenit 64 - 59/a te K.P - 8-gjykime

### **Prokurori Edina Kurti**

Hetuar - 183 proçedime penale  
Mosfillime - 114 kallzime

Derguar ne gjyq - 55 proçedime penale  
Pushuar - 33 proçedime penale  
Pezulluar - 57 proçedime penale  
Transferuar - 5 proçedime penale  
Mbartur - 33 proçedime penale

Zgjatje afatesh- 11-çeshje

Pjesemarrje ne gjykim me objekt sipas nenit 64-59/a te K.P - 17-gjykime

### **Prokurori Gezim Çopa** (periudha nga data 14.11.2016)

Hetuar - 13 proçedime penale  
Mosfillime- 7 kallzime

Derguar ne gjyq - 1 proçedime penale  
Pushuar - --- proçedime penale  
Pezulluar - --- proçedime penale  
Transferuar - --- proçedime penale

Zgjatje afatesh- -----çeshtje

Pjesemarrje ne gjykim me objekt sipas nenit 64-59/a te K.P - 3-gjykime

## **Prokurori Artan Madani**

Vendosur pezullimin e hetimeve per 2-proçedime penale.  
Vendosur pushimi per efekt parashkrimi neni 66 K.Pr.P per 18-çeshtje.

Gjate veprimtarise se punes se Prokuroreve duhet evidentuar si ngarkese dhe proçedimet penale per te cilat eshte vendosur pushimi per shkak parashkrimi gjithsej 93 - vendime pushimi per shkak parashkrimi sipas nenit 66 te K.Penal.

## **Ekstradimet dhe Leter-porosite**

Nje tjeter veprimtari qe duhet evidentuar jane dhe kerkesat per njohje vendimesh penale te autoriteteve te Drejtesise se shteteve te huaja.

Konkretisht rezultojne 4- raste proçedurash te ndjekura me kerkese per ekstradim nga autoritetet e vendeve te tjera (kryesisht Itali).

Rezultojne 3- raste proçedurash te ndjekura me kerkese per njohje vendimi penal ne huaj ne Gjykate.

Per 6-raste eshte proçeduar me veprime per leterporosive nga autoritetet e huaja.

Te gjitha kerkesat e Prokurorise jane pranuar nga Gjykata, dhe nuk ka patur ne asnje rast problematika.

Duhet evidentuar dhe shperndarja e ngarkeses se **Of/Pol/Gjyqesore te seksionit te Prokurorise** Adrian Elezi, Alan Xhili dhe Flori Bajramaj qe kane perballuar nje ngarkese prej 159 -çeshtjes penale.

### **Of/Pol/Gjyqesore Adrian Elezi**

Hetuar 71-çeshtje penale.

### **Of/Pol/Gjyqesore Alan Xhili**

Hetuar 73-çeshtje penale.

### **Of/Pol/Gjyqesore Flori Bajramaj**

Hetuar 15-çeshtje penale. (nga data 18.10.2016)

Duhet evidentuar si problematike mos marrja ne çdo rast e fashikullit per veprime hetimore me urdher per kryerje veprimesh hetimore apo delegim te posaçem sipas nenit 304/2 te K.Pr.Penale.

Ky moment eshte pergjegjesi dhe e Prokuroreve por dhe O.P.Gj te cilet nuk i trajtojne rastet sipas procedurave ligjore, pasi veprime te tilla sjellin pavlefshmeri te akteve te perpiluara.

Eshte perballuar nje ngarkese e konsiderueshme nga Seksioni i Pol/Gjyqesore te Policise se Shtetit. (problematika do trajtohet me poshte tek marredheniet me sherbimet e Policise)

## **VII. USHTRIMI I ROLIT DHE KOMPETENCAVE TE DREJTUESVE TE PROKURORISE.**

Ne veprimtarine e ndjekjes penale per ceshtjet e hetuara dhe te perfaqesuara ne gjykim, nje rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesit e Prokurorise, ne lidhje me studimin dhe vendimarrjen per regjistrimin e ceshtjeve penale, kontrollin ne dinamike, menyres se perfundimit te ceshtjeve, si dhe krijimit te marredhenieve me Prokuroret dhe Of/Pol/Gjyqesore, te seksionit te Prokurorise dhe seksioneve dhe sherbimeve te Policise, si dhe me Institucionet e tjera .

Gjate periudhes qe analizojme nga Drejtuesi i Prokurorise eshte ushtruar studimi i te gjitha materialeve kallzuese dhe te referuara nga Policia Gjyqesore e ato me vendngjarje, duke marre vendimet perkatese per regjistrimin e ceshtjeve.

Duhet nenvizuar fakti se ne te gjitha rastet eshte mbajtur nje qendrim i drejte dhe ligjor ne vleresimin paraprak te akteve te referuara.

Urdherat dhe udhezimet e Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, jane punuar dhe diskutuar per implementimin e tyre.

Eshte ushtruar kontroll ne dinamike te ceshtjeve penale gjate hetimeve paraprake, jane evidentuar dhe kerkuar verbalisht veprime konkrete qe duhet te kryhen, dhe nga ana Drejtuesit te Prokurorise eshte vendosur dhe shfuqizimi per 3- vendime perfundimtare te Prokuroreve.

Konkretisht jane shfuqizuar 1-vendim pushimi ceshtjes penale nr.365/2016, per vepren penale te parashikuar nga neni 134/2-22 K.Penal per veprime hetimore (Prokuror Ylli Dhimitri) ku me pas eshte vendosur pezullimi i hetimeve.

Shfuqizuar 1-vendim pushimi ceshtjes penale nr.161/2016, per vepren penale te parashikuar nga neni 290/2 K.Penal (Prokuror Edina Kurti) ku pas rihetimeve eshte vendosur pushimi.

Shfuqizuar 1-vendim mosfillimi nr. 544/2016, per vepren penale te parashikuar nga neni 277 K.Penal (Prokuror Ylli Dhimitri) ku me pas eshte vendosur regjistrimi i ceshtjes (ne hetim).

Shfuqizuar 1-vendim te dergimit te ceshtjes per gjykim nr.434/2016, per vepren penale te parashikuar nga neni 324/a/1 K.Penal (Prokuror Edina Kurti) duke vendosur ri-dergimi per gjykim.

Gjithashtu nga ana e Drejtuesit te Prokurorise jane ankimur (Apeluar) 1-vendime te Gjykates se Shkalles se Pare Kavaje. Konkretisht kunder nje vendimi pafajesie per te pandehuren Siva Negollari per nenin 290/4 te K.Penal. (Çeshtja eshte ne gjykim ne Apel)

Ne te gjitha rastet e zgjatjeve te afatit te hetimeve kerkesave per vlefesim dhe caktim mase sigurimi, si dhe konkluzioneve perfundimtare eshte zbatuar me korrektesi Urdheri i Prokurorit te Pergjithshem ne lidhje me kontrollin dhe ciklimin e tyre akteve dhe administrimin te nje kopje ne fashikullin perkates.

Jane organizuar dhe kryer analiza per ceshtje te vecanta te here pas-hershme, te protokolluara, ku eshte urdheruar me shkrim kryerja e veprimeve hetimore plotesuese.

## **VIII. MARREDHENIET ME INSTITUCIONET**

Marredhenie institucionale me Institucionet e tjera kane qene ne raporte ligjore dhe korrekte, kjo ne vecanti me Drejtorine e Policise se Qarkut Tirane, Komisarjatin e Policise Kavaje, si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Kavaje dhe Prokurorine prane Gjykates se Apelit Durres.

Marredheniet qe burojne per shkak te veprimtarise dhe procedurave ligjore, te hetimit dhe perfaqesimit ne gjygj, pra me Policine dhe Gjykatën, jane vleresuar si marredhenie bashkepunimi si ne aspektin organizativ ashtu dhe ate ligjor ne respektim te kryerjes se detyrave ne afate nga seksionet e Pol/Gjyqesore dhe sherbimet, ashtu dhe respektimin dhe korrektesine ne zhvillimin e seancave gjyqesore me Gjykatën.

### **GJYKATA**

Nuk jane evidentuar raste te shtyrjes se seancave gjyqesore per mosparaqitjen e Prokuroreve, dhe nga ana e Gjykates duhet vleresuar fakti i perballimit te nje ngarkese te madhe, ndonese ne nje numer te kufizuar Gjykatesish.

Por duhen evidentuar disa praktika te gabuara te Gjykates, ku ne raste te shpeshta shtyhen seancat gjyqesore vetem per shpallje vendimi, pra ne kundërshtim me nenin 379 K.Pr.P “*menjehershmeria e marrjes se vendimit*” dhe pas

shpalljes se vendimit pas disa ditesh ne Prokurori dergohet vetem nje shkurtim vendimi.

Ka raste shpesh qe seanca shtyhet per vendime te ndermjetme, per pranimin ose jo te gjykimit te shkurtuar (?).

Nuk zbardhen vendimet brenda afateve te parashikuara, dhe ka raste dhe te vendimeve per masa sigurimi te pa zbardhura.

Nje fenomen, qe ka kaluar ne nje problem, eshte shpejtesia e kalimit te ankimeve per ne Gjykatën e Apelit.

### **SHERBIMET E POLICISE**

Ne lidhje me materiale kallezuese, evidentohen mangesi te karakterit formal dhe procedural.

- Duhet evidentuar kryerja e veprimeve te pakta hetimore paraprake per rastet, duke u mjaftuar vetem me evidentimin e faktit nga nje burim, duke mos kryer veprime te tjera hetimore.
- Veprimet pas delegimit te hetimit, kryhen jo me nje dinamike, te pakonceptuara sipas nje plani hetimor, dhe aktet apo provat merren shume percipitazi duke lene shume paqartesi ne vijimesi.
- Proçes verbalet e sekuestrimit ka raste qe nuk paraqiten ne Prokurori brenda afatait procedural 48-oreshe, ose rezultojne te pa njoftuara paleve, si dhe vendimet per kryerje ekspertimesh ne pjesen me te madhe nuk behen njoftimet.
- Duhet terhequr vemendja sektorit te kriminalistikes ne lidhje me vonesat e akteve te ekspertimeve kimike (lendeve narkotike), dhe jo rralle dhe ekspertimeve mjeko-ligjore.

Ajo qe duhet evidentuar si mangesi eshte mos trajtimi i rasteve te shkeljeve duke kaluar ne proçedim disiplinor Of/pol/Gjyqesore. Gjate dinamikës se punes ne hetimin e çeshtjeve shpesh evidentojme te meta dhe mangesi, shkelje ligjore, qe jane trajtuar duke terhequr vemendjen apo kane mbetur thjesht ankime verbale. Per keto raste nga Drejtuesi i Prokurorisë u eshte kerkuar Prokuroreve qe te informojne me shkrim per rastet e konstatuara dhe jo te mbetemi thjesht ne ankesa te perditeshme, duke i trajtuar me fryme liberale dhe jo ligjore. Kjo eshte nje mangesi dhe per Drejtuesin ne rastet e konstatimit te ketij fakti.

### **ZYRA E PROKURORIT TE PERGJITHSHEM**

Gjithashtu duhen evidentuar marredheniet me Zyren e Prokurorit te Pergjithshem, ne funksion te zbatimit te urdherave dhe udhezimeve.

Evidentojme se nga nxjerrja e tyre kane gjetur zbatim dhe ndikuar ne mbarevajtjen e veprimtarise se Prokurorisë ne hetimin e çeshtjeve dhe perfaqesimin ne gjykim.

Gjithashtu ka patur nje bashkepunim per tu evidentuar me Zyren e Marredhenieve me Jashte, ne lidhje me ekzekutimin e leter-porosive me autoritetet e huaja, dhe praktikave per njohje vendimeve penale te huaja te cilat kane rezultuar ne nje numer te konsiderueshem kete vit, siç u permenden me lart.

Ne te gjitha rastet jane kryer proçedural brenda afateve, kjo dhe per bashkepunimin dhe ruajtjen e kontaktit ne dinamike per te gjitha rastet.

Duhet evidentuar fakti i nje bashkepunimi korrekt dhe me vlere per hetimet me zyren e S.P.M.T.Sh.I ne Prokurorine e Pergjithshme.

Nga ana e Prokurorise jane kerkuar dhe pranuar nga Gjykata kerkesa per pergjime ambientale dhe telefonike per 15-çeshtje, te cilat ne pjesen me te madhe te rasteve kane rezultuar me shume rendesi per çeshtjet, zbardhjen e faketeve dhe provueshmerise se akuzave ndaj te pandehurve.

Duhet evidentuar fakti, se ne lidhje me korespondencat, transkriptimet, apo administrimin e CD, eshte krijuar nje praktike e mire.

### **ADMINISTRATA**

Ne mbarevajtjen e punes te veprimtarise se Prokurorise nje rol te rendesishem kryen dhe administrata e Prokurorise.

Duhet evidentuar se sa i perket zyres se regjistrit ku eshte ngarkuar Of.Pol/Gkjqesore z. Adrian Elezi, rezulton se jane mbajtur me korrektesi regjistrat perkates, jane derguar brenda afateve te percaktuara evidencat.

Duhet angazhuar me teper ne lidhje me ndjekjen e azhornimeve, kjo mungese dhe e Prokuroreve.

Zyra e K/sekretarise ka perballuar volumin e protokolleve si dhe mbajtur evidencat financiare.

### **IX. DREJTIMET DHE PRIORITETET E PUNES PER VITIN 2017.**

Sa u referuan treguesit e siperpermendur, ne analize te tyre, duhet te evidentojme dhe drejtimet kryesore te punes dhe veprimtarise per vitin ne vazhdim 2017, duke percaktuar dhe prioritetet kryesore.

Nga drejtimet duhen vleresuar :

Se pari, nje nder drejtimet kryesore te veprimtarise se punes per vitin 2017, duhen evidentuar **ngritja e cilesise** se hetimeve, pra e cilesise se veprimeve hetimore te procedimeve penale.

Cilesia ne veprime pasqyron se pari ngritjen profesionale te çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqesore, duke e pasqyruar ate ne perpilimin e akteve, formulimit dhe arsyetimit ligjor te vendimeve gjate hetimit, ato perfundimtare si dhe perfaqesimit ne Gjykate.

Se dyti, duhet rritur ndjeshem **kontrolli ne dinamike** nga ana e prokuroreve gjate hetimeve paraprake te çeshtjeve, duke mos u mjaftuar vetem me nxjerrjen e nje urdheri per kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri ne ardhjen e akteve nga sherbimet e Pol.Gjyqesore, duke shkaktuar vonesa ne hetim, humbjen e aktualitetit te nje veprimi hetimore qe mund te rezultojë gjate dinamikës etj.

Ne dinamike gjate kontrollit te veprimtarise hetimore nga Of/pol/Gjyqesore Prokurori duhet te jete jo vetem nje orientues i veprimeve hetimore apo te nxjerre akte procedurale per veprime specifike si kontrole pergjime etj, por duhet te jete dhe inicues apo nxites per nje hetim sa me dinamik, te shpejte, te nje hetimi te zgjeruar per te gjitha problematikat. Duhet te evidentojë konkretisht dhe percjelle me informacione Drejtuesit te Prokurorisë apo ne Prokurori te Pergjithshme problematika te veçanta, pengesa te ndryshme qofte qe kane te bejne dhe me menyren e funksionimit te organizimit te punes se veprimtarise hetimore, siç jane zvarritjet etj.

Se treti, per çeshtje te veçanta per shkak te rrezikshmerise shoqerore apo perhapjes se nje krimi duke ju referuar tendences pra te kriminalitetit, aq me teper per çeshtje te renda dhe sensitive duhet bere **vleresimi i diferencuar per çeshtje te karakterit te rendesishem dhe sensitive**, kryer analiza te vleresimit te hetimeve dhe provave te administruara, duke lene detyra konkrete, si dhe duke kryer vete nga Prokuroret veprime hetimore.

Gjithashtu nga evidentimi i nje mangesie te vitit 2015 ne lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore nga vete Prokuroret, kete vit duhet vleresuar me korrektesi sidomos zbatimi i neni 256 te K.Pr.Penale ne lidhje me pyetjen e te arrestuarve, apo delegimi i perfundimit te hetimeve qe jo rrale u eshte deleguar Of/Pol/Gjyqesore. Marrja kontakt qe ne momentet e para nga Prokurori me te dyshuarin (arrestuarin) krijon nje perceptim me te drejte ne lidhje me hetimet qe do kryhen me pas, shmang dhe probleme procedurale ne lidhje me zgjedhjen e mases shtrenguese te marre nga sherbimet e Pol/Gjyqesore, si dhe per krijimin e nje politike te drejte te kerkeses per mase sigurimi, bazuar dhe ne personalitetin e te dyshuarit etj.

Se katerti, permiresimi i treguesit te shpejtesise ne hetim, respektimi i afateve hetimor.

Ne prioritetet per vitin ne vazhdim 2016 :

**Se pari**, Evidentimi, vleresimi dhe hetimi i veprave penale te referuara apo te evidentuara kryesisht, qe lidhen me veprimtari korruptive, apo dhe te

shpërdorimit të detyrës, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore.

Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për rastet kur konstatohen indicie për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndjehet shqetësim i përgjithshëm i komunitetit.

**Se dyti,** Kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, ku duhet përmendur vjedhjet, apo dhe ndertimet e paligjeshme, vjedhjet e energjisë elektrike si një nga prioritetet dhe të vitit të kaluar por që nuk rezultojnë rezultate.

**Se treti,** Rifillimi i çështjeve të pezulluara sipas nenit 326 të K.Pr.Penale, për veprat penale të rënda siç janë vrasjet e pazbuluara. Nga shërbimet e Policisë nuk ka asnjë rast të trajtimit të këtyre ngjarjeve në Prokurori pas pezullimit të tyre.

**Se katërti,** Aplikimi i formave të gjykimeve të posaçme të drejtepërdrejte, e cila përbën efikasitet si në goditjen e veprave penale të kryera nga subjektet por dhe në drejtim të ekonomisë gjyqësore.

Raportit i bashkëngjisim dhe tabelat përkatëse me treguesit statistikor.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.

-----

**DREJTUESI I PROKURORISE**

\_\_\_\_\_  
Artan MADANI